



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 707/1 prot.

Tiranë më 23.4.2021

Lënda: Mendim mbi një projektvendim.

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr.1979 prot., datë 16.04.2021, me anë së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për miratimin në parim, të Protokollit për amendimin e Marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës për Bashkëpunim Policor të Evropës Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve” dhe relacionin përkatës, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i vlerëson të hartuara në përputhje me ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

